



Kolegji AAB

Programi: Administratë Publike dhe Diplomaci

Studimet Master

Punim masteri

**DISKURSI NË DIPLOMACINË MEDIATIKE DIGJITALE:
LIDERËT SHETËTORË TË KOSOVËS
NË PLATFORMËN X**

Kandidatja:

Arbenita Bungu

Mentor

Prof. Ass. Dr. Hasan Saliu

Prishtinë, 2025



Kolegji AAB

Programi: Administratë Publike dhe Diplomaci

Studimet Master

Punim masteri

**DISKURSI NË DIPLOMACINË MEDIATIKE DIGJITALE:
LIDERËT SHETËTORË TË KOSOVËS
NË PLATFORMËN X**

Kandidatja:

Arbenita Bungu

Mentor

Prof. Ass. Dr. Hasan Saliu

Prishtinë, 2025

Ky punim masteri i dedikohet familjes time, por veçmas

Elmës,

Anidit,

Lunës dhe

Malzës.

Përmbajtja

Abstrakt	7
Kreu i parë	8
1.1. Hyrje	8
1.1.1 Qëllimi i këtij punimi të masterit	9
1.1.2. Objektivat	10
1.1.3. Pyetjet kërkimore	10
1.1.4. Hipotezat	11
1.1.5. Rëndësia e temës	11
1.1.6. Metodologjia	11
1.1.7. Rezultatet e pritura	13
1.1.8. Përmbledhje	14
Kreu i dytë	Error! Bookmark not defined.
2.1. Diplomacia dhe kuptimi i saj	Error! Bookmark not defined.
2.1.1. Evoluimi i diplomacisë - Nga tradicionalja në publike	Error! Bookmark not defined.
2.1.2. Diplomacia mediatike	Error! Bookmark not defined.
2.1.3. Diplomacia digjitale	Error! Bookmark not defined.
2.1.4. Diplomacia Mediatike Digjitale	Error! Bookmark not defined.
2.1.5. Platformat e diplomacisë mediatike digjitale	Error! Bookmark not defined.
Kreu i tretë	Error! Bookmark not defined.
3.1. Diplomacia Mediatike Digjitale në Kosovë	Error! Bookmark not defined.
3.1.1 Roli i Presidentit e Kryeministrit të Kosovës në diplomacinë mediatike digjitale	Error! Bookmark not defined.
3.1.2. Twiplomacy: Diplomacia në 280 shkronja/karaktere	Error! Bookmark not defined.
3.1.3. Platforma X si mjet i diplomacisë mediatike	Error! Bookmark not defined.
Kreu i katërt	Error! Bookmark not defined.
4.1. Diskursi i Presidentes së Kosovës në X pas sulmit në Banjskë	Error! Bookmark not defined.
4.1.1. Diskursi i Kryeministrit të Kosovës në X pas sulmit në Banjskë	Error! Bookmark not defined.
Kreu i pestë	Error! Bookmark not defined.
5.1. Interaktiviteti i përgjithshëm i postimeve	Error! Bookmark not defined.
5.1.1. Kategoritë e postimeve	Error! Bookmark not defined.
5.1.2. Kategori më të shpeshta të përdorura nga Albin Kurti	Error! Bookmark not defined.
5.1.3. Kategori më të shpeshta të përdorura nga Vjosa Osmani	Error! Bookmark not defined.
5.1.4. Përmbajtja e postimeve të Albin Kurtit dhe Vjosa Osmanit	Error! Bookmark not defined.
5.1.5. Krahasimi i terminologjisë në postimet e Kurtit dhe Osmanit	Error! Bookmark not defined.

5.1.6. Dallimet kryesore	Error! Bookmark not defined.
5.1.7. Përdorimi i fjalëve të përbashkëta.....	Error! Bookmark not defined.
5.1.8. Elementet ndërkombëtare	Error! Bookmark not defined.
Kreu i gjashtë.....	Error! Bookmark not defined.
6.1. Përfundim	Error! Bookmark not defined.
6.1.1. Rekomandime	Error! Bookmark not defined.
Bibliografia.....	15

Fig. 1. Postim në X – Vjosa Osmani.....	37
Fig. 2. Postim në X – Vjosa Osmani	42
Fig. 3. Postim në X – Vjosa Osmani	43
Fig. 4. Postim në X – Albin Kurti	44
Fig. 5. Postim në X – Albin Kurti	45
Fig. 6. Postim në X – Albin Kurti	47
Fig. 7. Postim në X – Albin Kurti	50
Fig. 8. Interaktiviteti i përgjithshëm i postimeve	52
Fig. 9. Albin Kurti – Kategorizimi i postimeve	54
Fig. 10 Vjosa Osmani – Kategorizimi i postimeve	55
Fig. 11 Përmbajtja e statuseve	56
Fig. 12 Word cloud – Albin Kurti	58
Fig. 13. Word Cloud – Vjosa Osmani	58
Fig. 14 Statistikat e fjalëve më të përdorura	59

Abstrakt

Diplomacia e mediave digjitale është thuar një mjet bazik dhe i domosdoshëm për qeveritë për të arritur qëllime diplomatike në epokën moderne. Kjo tezë shqyrton përpjekjet e diplomacisë mediatike digjitale të liderëve shtetërorë të Kosovës, Presidentes Vjosa Osmani-Sadriu dhe Kryeministrit Albin Kurti, në Platformën X (ish-Twitter). Studimi analizon të gjitha postimet e tyre në X gjatë 25 ditëve, nga 24 shtatori deri më 18 tetor 2023, pas një sulmi terrorist në Banjskë të Zveçanit, ku një pjesëtar i Policisë së Kosovës u vra nga një grup i armatosur serb. Hulumtimi përdor një qasje të metodave të përziera, duke kombinuar metodën framing, analizën diskursive dhe atë të matjes sasiore/frequency. Studimi thekson rolin e liderëve shtetërorë në formësimin e opinionit publik dhe diskursit e përdorur në platformën X. Gjetjet e këtij studimi kontribuojnë në literaturën mbi diplomacinë e mediave digjitale dhe demonstrojnë se si udhëheqësit shtetërorë mund të përdorin platformat digjitale për të çuar përpara agjendat e tyre diplomatike.

Fjalët kyçe: diplomacia mediatike digjitale, diskursi, liderët, Twiplomacy, postimet, imazhi.

Abstract

Digital media diplomacy is an essential and almost fundamental tool for governments to achieve diplomatic objectives in the modern era. This thesis examines the digital media diplomacy efforts of Kosovo's state leaders, President Vjosa Osmani-Sadriu and Prime Minister Albin Kurti, on Platform X (formerly Twitter). The study analyzes all their posts on X over 25 days, from September 24 to October 18, 2023, following a terrorist attack in Banjska, Zvečan, where a member of the Kosovo Police was killed by a Serbian armed group. The research employs a mixed-methods approach, combining framing analysis, discourse analysis, and quantitative/frequency measurement. The study highlights the role of state leaders in shaping public opinion and the discourse used on Platform X. The findings contribute to the literature on digital media diplomacy and demonstrate how state leaders can leverage digital platforms to advance their diplomatic agendas.

Key words: digital media diplomacy, discourse, leaders, Twiplomacy, posts, image.

Kreu i parë

1.1. Hyrje

Pavarësisht ndryshimeve thelbësore në fushë veprimtarinë e tyre, diplomacia, mediat dhe digjitalizimi kanë arritur që në fakt të krijojnë një teori të vetme, atë të diplomacisë mediatike digjitale. Si një koncept relativisht i ri, kjo teori nënkupton përdorimin e teknologjisë dhe platformave digjitale nga qeveritë, diplomatët, dhe organizata të ndryshme në mënyrë që të arrijnë qëllime diplomatike. Sipas statistikave të janarit 2024, ka 5.35 miliardë përdorues të internetit në mbarë botën, që përbën 66.2 përqind të popullsisë globale. Statistikat për vitin 2024, tregojnë se kishte 5.52 miliardë përdorues të internetit në mbarë botën, që përbënin 67.5 përqind të popullsisë globale. Nga ky total, 5.22 miliardë, ose 63.8 përqind e popullsisë botërore, ishin përdorues të mediave sociale.¹

Ndonëse si të ndara, diplomacia mediatike dhe diplomacia digjitale janë shtjelluar më shumë, teoria e diplomacisë mediatike digjitale është shumë pak e përdorur në literaturën ekzistuese. Sipas Saliut, diplomacia e medias digjitale lejon që një mesazh i vetëm të shndërrohet në një formë shumëdimensionale komunikimi që ndikon si audiencën vendase ashtu edhe atë të huaj, duke demonstruar kështu fuqinë e saj në botën e politikës së jashtme dhe çështjeve ndërkombëtare.² Qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare, sipas studiuesit Marcus Holmes, tani po kuptojnë se mediat sociale janë gjithashtu një ndryshim potencial i lojës për mënyrën se si mund të ndiqen marrëdhëniet ndërkombëtare.

Në veçanti, adaptimi i diplomacisë digjitale, të cilën Bjola dhe Holmes e përkufizojnë gjerësisht si përdorimi i mediave sociale për qëllime diplomatike, mund të ndryshojë praktikën se si diplomatët angazhohen në menaxhimin e informacionit, diplomacinë publike, planifikimin e strategjisë, negociatat ndërkombëtare apo edhe menaxhimin e krizave.³ Diplomacia mediatike, sipas Eytan Gilboas, i referohet përdorimit të medias nga zyrtarët për të komunikuar me aktorët shtetërorë dhe jo

¹ "Number of internet and social media users worldwide as of January 2025," *Statista*, <https://www.statista.com/statistics/617136/digital-population-worldwide/> qasur me 30/12/2024

², Hasan Saliu, "Rethinking Media Diplomacy And Public Diplomacy Towards A New Concept: Digital Media Diplomacy", *Online Journal Modelling The New Europe*, no. 39 (2022): 17.

³ Corneliu, Bjola and Marcus Holmes, *Digital diplomacy: Theory and Practice*, (London: Routledge, 2015), 4.

shtetërorë, për të ndërtuar besimin dhe për të çuar përpara negociatat dhe për të mobilizuar mbështetjen publike për marrëveshje.⁴ Në zhvillim e sotëm teknologjik, koncepti i diplomacisë mediatike digjitale është një komponent i domosdoshëm i praktikës diplomatike bashkëkohore. Për më tepër, ajo ka demokratizuar praktikën e diplomacisë, duke lejuar aktorët jo shtetërorë, si organizatat e shoqërisë civile, grupet e avokimit dhe individët, të marrin pjesë në kohë reale në diskursin diplomatik.

Shumë shpesh, mesazhet e dhëna nga aktorë shtetëror kanë ndikuar për të mirë apo për të keq në vende të ndryshme të botës, sidomos në aspektin politik. Në këtë aspekt, nëpërmjet këtij punimi, synojmë të paraqesim rolin e udhëheqësve të shtetit të Kosovës në diplomacinë mediatike digjitale nëpërmjet platformës X (dikur Twitter). Më konkretisht, do analizohen në mënyrë përmbajtjesore mesazhet që janë postuar në platformën X nga Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu dhe Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Analiza përfshin të gjitha postimet për 25 ditë rresht, nga data e sulmit më 24 shtator deri më 18 tetor të vitit 2023. Kjo periudhë është përcaktuar me qëllimin që të analizohen reagimet e krerëve shtetëror pas vrasjes së një pjesëtari të Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, dhe plagosjes së një tjetri, në Banjskë të Zveçanit, nga një grup i armatosur serb brenda territorit të Kosovës. Për më shumë, do të analizohet dhe krahasohet edhe aspekti kuantitativ i postimeve. Këtu do të përfshihen statistikave e numrit të shikueshmërisë së postimeve, numri i pëlqimeve, komenteve, fotove, videove, ripostimeve, bookmarks, hashtags, URL, mention(tag), si dhe numri i përdorimit të flamujve si simbole.

1.1.1 Qëllimi i këtij punimi të masterit

Qëllimi i këtij punimi të masterit është të analizohen në aspektin përmbajtjesor dhe diskursiv postimet në platformën X(dikur Twitter) nga Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu dhe Kryeministri, Albin Kurti. Analiza përfshin konkretisht postimet me rastin e sulmit në Banjskë të Zveçanit, ku nga një grup i armatosur serb në territorin e Kosovës u vra një pjesëtar i Policisë së Kosovës. Andaj, nëpërmjet këtij hulumtimi, do të analizohet diplomacia mediatike digjitale e Kosovës në kohë reale të krizës, si dhe aspekti

⁴ Eytan Gilboa, *Diplomacy in the media age: Three models of uses and effects*, *Diplomacy & Statecraft*, (London: 2001), 10.

diskursiv i mesazheve të liderëve shtetëror. Hulumtimi në këtë fushë mund të ndihmojë në identifikimin e praktikave më të mira si dhe vlerësimin e efektivitetit të iniciativave të diplomacisë diplomatike mediatike digjitale.

1.1.2. Objektivat

- Të grumbullojmë dhe analizojmë në aspektin diskursiv përmbajtjesor postimet e Presidentes dhe Kryeministrit të Kosovës në platformën X;
- Të sqarojmë termat dhe teoritë kryesore të diplomacisë mediatike digjitale;
- Të masim përfshirjen e audiencës në postimet e Presidentes dhe Kryeministrit;
- Të identifikojmë, analizojmë dhe interpretojmë faktorët që ndikojnë në forcimin e diplomacisë mediatike digjitale;
- Mbi bazën e të dhënave teorike, statistikore dhe diskursive të nxjerrim përfundime në raport me rëndësinë e diplomacisë mediatike digjitale;

1.1.3. Pyetjet kërkimore

Pyetjet kryesore që shtrohen në këtë punim të masterit, në të cilat jemi përpjekur të japim përgjigje janë:

1. Çfarë mesazhe janë përcjellë në platformën X nga krerët shtetëror me rastin e sulmit terrorist në Banjskë?
2. Çfarë roli kanë krerët shtetëror në diplomacinë mediatike digjitale?
3. Pse e përdorin krerët shtetëror të Kosovës platformën X si kanal komunikimi?
4. Sa i kushtojnë rëndësi paraqitjes vizuale në X Presidentja dhe Kryeministri?
5. Deri në çfarë mase postimet e Presidentes dhe Kryeministrit të Kosovës e angazhojnë audiencën?

1.1.4. Hipotezat

H1: Presidentja dhe Kryeministri i Kosovës përdorin diplomacinë mediatike digjitale për t'i bërë presion Serbisë që të respektojë normat dhe ligjet ndërkombëtare.

H2 : Presidentja dhe Kryeministri i Kosovës përmes platformës X e formësojnë imazhin e Kosovës si viktimë e agresionit serb, për të sensibilizuar opinionin e huaj publik dhe për të arritur përkrahje ndërkombëtare.

1.1.5. Rëndësia e temës

Në mungesë të studimeve rreth diplomacisë mediatike digjitale në Kosovë, sidomos në gjuhën shqipe, ky punim do të jetë një referencë shkencore për studiues të mediave dhe atyre të diplomacisë. Punimi si i tillë do të sqarojë terma të diplomacisë mediatike digjitale, mënyrën e realizimit të saj, do të analizojë mesazhet e dërguara jashtë si dhe do të interpretojë ndikimin dhe rëndësinë e tyre. Të gjeturat nga ky punim do të afektojnë edhe udhëheqësit e shtetit të cilët, duhet të kenë parasysh se jo vetëm veprimet, por edhe fjalët e tyre mund të ndikojnë si për të mirë, ashtu edhe për të keq në diplomaci. Si rrjedhojë, rëndësia e kësaj teme qëndron në faktin se analizat do të çojnë në rekomandime konkrete, të cilat do të mund t'i shërbejnë krerëve shtetëror të Kosovës në përmirësimin e mënyrës të përcimit të mesazheve të tyre.

1.1.6. Metodologjia

Në këtë punim kemi përdorur qasjen e teknikës metodologjike Framing*⁵, analizën kritike diskursive, si dhe analizën e frekuencës. Kjo ngaqë gjatë hulumtimit të kësaj teme jemi fokusuar në analizën përmbajtjesore të mesazheve të postuara në platformën X, si dhe kemi analizuar edhe përfshirjen numerike të audiencës. Si mostër do të analizohen postimet në platformën X të Presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu dhe Kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti me rastin e sulmit në Banjskë të Mitrovicës.

⁵ **Frame-framing** është fjalë në gjuhën angleze, e cila në shqip përkthehet në këto kuptime: Kornizë, kuadër, skelet, formë, strukturë, inkuadrim. Në kontekstin gjeneral të përdorimit të metodës Framing, nënkuptohet analiza e mesazhit, imazhit, aktorit etj.

Analiza përfshin të gjitha postimet për 25 ditë rresht, nga data e sulmit ku u vra një pjesëtar i Policisë së Kosovës dhe një tjetër u plagos, pra më 24 shtator deri më 18 tetor të vitit 2023.

Të dhënat janë analizuar bazuar në teorinë e inkuadrimin të efekteve mediatike.⁶ Kjo metodë analize, sipas Scheufele, merr në konsideratë qëllimet e mesazheve mediatike, të cilat ndikojnë tek audienca dhe shpesh kanë të bëjnë me konstruktin social të realitetit.⁷ Të gjitha deklaratat synojnë të ndikojnë tek audienca, d.m.th., aktorët shtetërorë ndërkombëtarë, të vëzhguar nën thjerrëzën e teorisë së kornizës, e cila shqyrton efektet mediatike në ndërtimin social të realitetit.⁸ Veçanërisht, sipas De Vreese dhe Entman, framing (kornizimi) bazohet në përzgjedhje, përjashtim dhe theksim, pasi komunikuesi zgjedh cilat informacione të përfshihen, cilat të hiqen dhe cilat të theksohen përmes vendosjes, përsëritjes ose lidhjes me simbole të rëndësishme kulturore.⁹ Sipas Entman, ndërkaq, kornizat përcaktojnë problemet, shkaqet e diagnostikimit bëjnë gjykime morale dhe sugjerojnë zgjidhje.¹⁰ Duke trajtuar pothuajse të njëjtën tematikë, Saliu dhe Abrashi, theksojnë se rastet e përmendura më sipër kanë të bëjnë me diplomacinë mediatike dhe analizohen nga këndvështrimi i inkuadrimin (framing). Mesazhe të tilla politike synojnë të përcaktojnë problemin, të diagnostikojnë shkaqet, të bëjnë gjykime morale dhe të sugjerojnë zgjidhje.¹¹

Ndërkaq, në aspektin diskursiv, sipas Hajer, ne i qasemi një diskursi si një grup thëniesh të ndërlidhura që avancojnë një linjë argumenti, i bëjnë lexuesit të përqendrohen në disa çështje ndërsa mbyllin ose errësojnë të tjerat dhe kanë implikime për mënyrën se si realiteti shoqëror shihet dhe përjetohet.¹² Një pjesë e madhe e literaturës, aplikon

⁶ Hasan Saliu &, Gazmend Abrashi, "The Return of Media Diplomacy: Examples from Kosovo," *Jurnal Ilmu Sosial dan Ilmu Politik* 27, no. 1 (July 2023): 79.

⁷ Dietram A. Scheufele, "Framing as a Theory of Media Effects," *Journal of Communication* 49, no. 1 (1999): 104-105.

⁸ Ibid.

⁹ Claes H. De Vreese, Joost Peter, and Hajo G. Boomgaarden, "Framing Politics at the Launch of the Euro: A Cross-National Comparative Study of Frames in the News," *Political Communication* 18 (2001): 107-122, Robert M. Entman, "Framing: Toward Clarification of a Fractured Paradigm," *Journal of Communication* 43, no. 4 (1993): 51-58, cituar në Ilan Manor & Rhys Crilley, "Visually framing the Gaza War of 2014: The Israel Ministry of Foreign Affairs on Twitter," *Media, War & Conflict* 11 (2018): 371

¹⁰ Ibid. cituar në Hasan Saliu & Gazmend Abrashi, "The Return of Media Diplomacy: Examples from Kosovo," *Jurnal Ilmu Sosial dan Ilmu Politik* 27, no. 1 (July 2023): 74-89.

¹¹ Ibid. 84

¹² Maarten A. Hajer, *The Politics of Environmental Discourse: Ecological Modernization and the Policy Process* (Oxford: Oxford University Press, 1995), cituar në Farhad Mukhtarov, Des Gasper, Aditya Alta, Neha Gautam, Maria Sattwika Duhita, and Diego Hernández Morales, "From 'Merchants and Ministers' to 'Neutral Brokers'? Water Diplomacy Aspirations by the Netherlands – A Discourse Analysis of the 2011

teknika të analizës së diskursit për dokumentet dhe raportet e politikave, të tilla si deklaratat e liderëve politikë, një përfaqësim mediatik, thekson Montessori et al.¹³ Pra, përmes këtyre metodave synojmë të shpjegojmë, shqyrtojmë dhe analizojmë në thellësi problematikën e studimit.

Në matje do të përfshihet edhe shpeshësia e përdorimit të fjalëve, kjo përmes analizës së frekuencës së fjalëve, sepse ajo, sipas Franzosi dhe Mukhtarov, tregon zgjedhjet e fjalëve të bëra, qofshin të bëra me vetëdije apo pa vetëdije, gjeneron njohuri që leximi i zakonshëm nuk do të bënte, dhe ndihmon për të identifikuar fushat ku analiza e mëtejshme gjuhësore mund të jetë produktive (Franzosi, 2008). Numërimi i shpeshësisë së fjalëve përdoret gjithnjë e më shumë në studimin e politikave mjedisore, sepse ato shpesh tregojnë kontraste çuditërisht të mprehta midis teksteve. Metoda natyrisht nuk është e mjaftueshme veçmas dhe duhet të kombinohet me metoda të tjera.¹⁴

1.1.7. Rezultatet e pritura

Siç është theksuar edhe më lart, duke qenë një temë jo shumë e trajtuar, e po ashtu edhe një koncept i ri, ndër rezultatet e para do të jetë sqarimi i termave dhe teorive kryesore të diplomacisë mediatike digjitale. Në këtë rrafsh, do të shtjellohet edhe historiku i diplomacisë dhe nënlojeve të saj, nga e cila do ketë një pasqyrë me të qartë të rëndësisë së diplomacisë mediatike digjitale. Pas grumbullimit dhe analizimit të mesazheve të krerëve shtetërorë të Kosovës të publikuara në platformën X, rezultati kryesor që presim është të identifikojmë, analizojmë dhe interpretojmë faktorët që ndikojnë në forcimin e diplomacisë mediatike digjitale nëpërmjet përdorimit adekuat dhe specifik të gjuhës.

Nga këto të dhëna, presim që të pohojmë ose mohojmë hipotezat e ngritura në mënyrë që të dihen rezultatet konkrete të hulumtimit. Po ashtu, ndër rezultatet e synuara është të arrijmë të japim përgjigje në pyetjet kërkimore të cilat janë baza e hulumtimit.

Commissioned Advisory Report, "International Journal of Water Resources Development 38, no. 6 (2022): 1011.

¹³Nicolina Montesano Montessori, Michael Farrelly, and Jane Mulderrig, eds., *Critical Policy Discourse Analysis* (Edward Elgar, 2019), cituar në Ibid. 1012.

¹⁴ Roberto Franzosi, ed., *Content Analysis (4 volumes)*, (SAGE Publications, 2008), cituar Ibid. 1027.

1.1.8. Përmbledhje

Për të arritur një strukturë profesionale, akademike dhe të qartë për lexuesin, punimi do të ndahet në krerë si vijon:

Kreu I: Përmban pjesën hyrëse, metodologjinë e përdorur, hipotezat dhe objektivat e përgjithshme të punimit.

Kreu II: Do të përmbajë shpjegim të literaturës në lidhje me konceptet kryesore të diplomacisë mediatike, diplomacisë digjitale dhe diplomacisë mediatike digjitale. Nga aspekti historik, do të trajtohet zhvillimi i diplomacisë dhe mediave për të dhënë idetë bazë se si ka filluar diplomacia mediatike digjitale.

Kreu III: Në këtë kre do të flitet rreth diplomacisë mediatike digjitale në Kosovë. Po ashtu, do të analizohet Roli i Presidentit dhe Kryeministrit të Kosovës në diplomacinë mediatike digjitale, në veçanti për platformën X.

Kreu IV: Si mostër studimi këtu do të analizohen në aspektin diskursiv postimet në platformën X nga Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu dhe Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti më rastin e sulmit në Banjskë. Analiza përfshin të gjitha postimet për 25 ditë rresht, nga data 24 shtator deri më 18 tetor të vitit 2023.

Kreu V: Në këtë pjesë do të analizohet aspekti i përfshirjes numerike të audiencës, apo engagement, duke u paraqitur me statistika dhe grafikone.

Kreu VI: Në kreun e fundit do të paraqesim pas analizave dhe rezultateve, përfundimet dhe rekomandimet konkrete.

Bibliografia

- Albishri, Osama, et al. "Mediated public diplomacy in the digital age: Exploring the Saudi and the U.S. governments' agenda-building during Trump's visit to the Middle East." *Public Relations Review*, 45, no. 4 (2019).
<https://doi.org/10.1016/j.pubrev.2019.101820>
- Archetti, Cristina. "Media impact on diplomatic practice: An evolutionary model of change." Paper presented at the American Political Science Association (APSA) Annual Convention, Washington, DC, September 2-5, 2010.
- Azpiroz, Maria Luisa. "Framing as a tool for mediatic diplomacy analysis: study of George W. Bush's political discourse in the 'War on Terror'." *Communication & Society/Comunicación y Sociedad* 26, no. 2 (2013): 176-197.
DOI:[10.15581/003.26.36126](https://doi.org/10.15581/003.26.36126)
- Barston, Ronald Peter. *Modern Diplomacy*. 4th ed., Routledge, 2006.
https://www.ucg.ac.me/skladiste/blog_615742/objava_124383/fajlovi/R.%20P
- Barrinha, André, and Renard Thomas. "Cyber-diplomacy: the making of an international society in the digital age." *Global Affairs* 3, no. 4-5 (2017): 353-364. <https://doi.org/10.1080/23340460.2017.1414924>
- Berkman Köseleli, Berna. "Strategic communication through new media in US diplomacy." In *Current Studies over Social Sciences*, 42-63. iksad publishing house, 2018.
- Bjola, Corneliu, and Ilan Manor, eds. *The Oxford Handbook of Digital Diplomacy*. Oxford University Press, 2024.
<https://doi.org/10.1093/oxfordhb/9780192859198.001.0001>
- Bjola, Corneliu, and Marcus Holmes. *Digital Diplomacy: Theory and Practice*. Routledge, 2015.
- Bjola, Corneliu, and Markus Kornprobst. *Understanding International Diplomacy Theory, Practice and Ethics*. 2nd ed., Routledge, 2018.
- Bjola, Corneliu, Jennifer Cassidy, and Ilan Manor. "Public Diplomacy in the Digital Age." *The Hague Journal of Diplomacy*. DOI:[10.1163/1871191X-14011032](https://doi.org/10.1163/1871191X-14011032)
- Bjola, Corneliu. "The 'dark side' of digital diplomacy: countering disinformation and propaganda." Elcano Royal Institute, 2019.

- <https://media.realinstitutoelcano.org/wp-content/uploads/2021/11/ari5-2019-bjola-dark-side-digital-diplomacy-counterering-disinformation-propaganda.pdf>
- Boriçi, Hamit, et al. *Gazetaria*. Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2000.
- Castells, Manuel. "The New Public Sphere: Global Civil Society, Communication Networks, and Global Governance." *Annals of The American Academy of Political and Social Science* 616 (2008): 78-93.
DOI:[10.1177/0002716207311877](https://doi.org/10.1177/0002716207311877)
- Cull, Nicholas J. *Public Diplomacy: Lessons from the Past*. Figueroa Press, 2009.
<http://kamudiplomasisi.org/pdf/kitaplar/PDPerspectivesLessons.pdf>
- De Vreese, Claes H., Joost Peter, and Hajo G. Boomgaarden. "Framing Politics at the Launch of the Euro: A Cross-National Comparative Study of Frames in the News." *Political Communication* 18 (2001): 107–122.
- Di Martino, Luigi. "Conceptualising public diplomacy listening on social media." *Place Branding and Public Diplomacy*, 2019. <https://doi.org/10.1057/s41254-019-00135-5>
- Entman, Robert M. "Framing: Toward Clarification of a Fractured Paradigm." *Journal of Communication* 43, no. 4 (1993): 51–58.
- Fidler, Roger. *Mediamorfoza*. Instituti Shqiptar i Medias, 2001.
- Franzosi, Roberto, ed. *Content Analysis* (4 volumes). SAGE Publications, 2008.
- Gërguri, Dren. *Komunikimi politik në epokën e medieve sociale*. Prishtinë: Fondacioni-Konrad-Adenauer, 2021.
- Gilboa, Eytan. "Diplomacy in the media age: Three models of uses and effects." *Diplomacy & Statecraft*, Routledge, 2001.
- Gilboa, Eytan. "Diplomacy in the media age: Three models of uses and effects." *Diplomacy & Statecraft* 12, no. 2 (2001): 1-28.
<https://doi.org/10.1080/09592290108406201>
- Gilboa, Eytan. *The Global News Networks and U.S. Policymaking In Defense and Foreign Affairs*. The Shorenstein Center on the Press, Politics and Public Policy, 2002. https://shorensteincenter.org/wp-content/uploads/2012/03/2002_06_gilboa.pdf
- Golan, G. J., Manor, I., & Arceneaux, Ph. "Mediated Public Diplomacy Redefined: Foreign Stakeholder Engagement via Paid, Earned, Shared, and Owned Media."

- American Behavioral Scientist* 63, no. 2 (2019): 1665–1683.
<https://doi.org/10.1177/000276421983527>
- Gorenc, Nina. "Political communication in post-truth society." *Ars & Humanitas* 14 (2020): 73-87. DOI:[10.4312/ars.14.1.73-87](https://doi.org/10.4312/ars.14.1.73-87)
- Hajer, Maarten A. *The Politics of Environmental Discourse: Ecological Modernization and the Policy Process*. Oxford: Oxford University Press, 1995.
https://culturaldiplomacy.org/academy/pdf/research/books/soft_power/The_New_Public_Diplomacy.pdf
- Idrizi, Zeqirja. *Historia e diplomacisë*. Kolegji Fama, 2013.
- Jungherr, Andreas. "Twitter in Politics: A Comprehensive Literature Review." SSRN, February 27, 2014. https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2402443
- Jungherr, Andreas. *Analyzing Political Communication with Digital Trace Data - The Role of Twitter Messages in Social Science Research*. Springer, 2015.
- Kaplan, Andreas, and Michael Haenlein. "Users of the World, Unite! The Challenges and Opportunities of Social Media." *Business Horizons* 53 (2010): 59-68.
<https://doi.org/10.1016/j.bushor.2009.09.003>
- Knäpper Bohman, Clara. "Digital Diplomacy - Social Media Platforms as Instruments for Implementing Foreign Policy." Diplomatische Akademie Wien, 2016.
https://www.academia.edu/37352727/DIGITAL_DIPLOMACY_Social_Media_Platforms_as_Instruments_for_implementing_Foreign_Policy_An_empirical_analysis_of_the_Swedish_Embassy_in_Viennas_use_of_Facebook_and_Twitter_as_means_to_carry_out_Swedish_Feminist_Foreign_Policy_Table_of_Content
- Kunczik, Michael. "Globalization: News Media, Images of Nations and the Flow of International Capital with Special Reference to the Role of Rating Agencies." Paper presented at the IAMCR Conference, Singapore, July 17-July 20, 2000.
<https://www.files.ethz.ch/isn/46966/2001-02-Globalization.pdf>
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Prishtinë: Kuvendi i Kosovës, 2008.
www.gazetazyrtare.com
- Kval, Karl Erik, et al. *Politika dhe demokracia*. Rozafa, 2006.
- Lin, Zhi. "A Virtual Battlefield for Embassies: Longitudinal Network Analysis of Competing Mediated Public Diplomacy on Social Media." *Political Communication* (2024). <https://doi.org/10.1080/10584609.2024.2312865>.

- Manor, Ilan, and Rhys Crilley. "The Mediatisation of MFAS: Diplomacy in the New Media Ecology." *The Hague Journal of Diplomacy* 15 (2019): 1-27.
DOI:[10.1163/1871191X-15101051](https://doi.org/10.1163/1871191X-15101051)
- Manor, Ilan, and Rhys Crilley. "Visually framing the Gaza War of 2014: The Israel Ministry of Foreign Affairs on Twitter." *Media, War & Conflict* 11 (2018): 369-391.
https://www.researchgate.net/publication/328910230_Visually_framing_the_Gaza_War_of_2014_The_Israel_Ministry_of_Foreign_Affairs_on_Twitter
- Manor, Ilan. "Are We There Yet: Have MFAs Realized the Potential of Digital Diplomacy?", University of Oxford, 2016, DOI:[10.1163/24056006-12340002](https://doi.org/10.1163/24056006-12340002)
- Manor, Ilan. "Digital public diplomacy." 2023. DOI:[10.1007/978-3-030-04405-3](https://doi.org/10.1007/978-3-030-04405-3)
- Marinelli, Alberto, and Romana Andò. "From Linearity to Circulation How TV Flow Is Changing in Networked Media Space." *Tecnoscienza Italian Journal of Science and Technology Studies* 7, no. 2 (2016): 105-129.
- Maurer, Tim. "Social Media and International Affairs: An Opportunity and Risk for Democracy." *International Affairs Forum* 4, no. 1 (2013): 95-97.
<https://doi.org/10.1080/23258020.2013.824237>.
- Mboya, Cliff. "Kenya's Digital Diplomacy amid COVID-19: New Tools in an Old Toolbox?" *South African Journal of International Affairs* 28, no. 3 (2021): 429-448. <https://doi.org/10.1080/10220461.2021.1960596>.
- McNair, Brian. *An Introduction to Political Communication*. 5th ed., Routledge, 2011.
- Mekuli, Gwzim. *Mediat dhe politika (1999-2006)*. Mekuli Press, 2006.
- Melissen, Jan. *New Public Diplomacy: Soft Power in International Relations*. Palgrave Macmillan, 2005.
- Montessori, Nicolina Montesano, Michael Farrelly, and Jane Mulderrig, eds. *Critical Policy Discourse Analysis*. Edward Elgar, 2019.
- Mukhtarov, Farhad, Des Gasper, Aditya Alta, Neha Gautam, Maria Sattwika Duhita, and Diego Hernández Morales. "From 'Merchants and Ministers' to 'Neutral Brokers'? Water Diplomacy Aspirations by the Netherlands – A Discourse Analysis of the 2011 Commissioned Advisory Report." *International Journal of Water Resources Development* 38, no. 6 (2022): 1009-1031,
<https://doi.org/10.1080/07900627.2021.1929086>

- Nye, Joseph S., Jr. "Soft power: the evolution of a concept." *Journal of Political Power*, 2021. <https://doi.org/10.1080/2158379X.2021.1879572>
- Nye, Joseph S., Jr. *Soft Power: The Means to Success in World Politics*. PublicAffairs, 2004.
- O'Neill, Mary, ed. *Compact dictionary of contemporary English*. Chambers Harrap Publishers Ltd, 2010.
- Pamment, James. "Digital diplomacy as transmedia engagement: Aligning theories of participatory culture with international advocacy campaigns." *New Media & Society* 18, no. 9 (2016): 2046–2062. <https://doi.org/10.1177/1461444815577792>
- Pew Research Center. "Teens, Social Media and Technology 2023", December 2023. <https://www.pewresearch.org/internet/2023/12/11/teens-social-media-and-technology-2023/>
- Pond, Philip, and Lewis, Jeff. "Riots and Twitter: Connective Politics, Social Media and Framing Discourses in the Digital Public Sphere." *Information, Communication & Society* 22, no. 2 (2019): 213-231. <https://doi.org/10.1080/1369118X.2017.1366539>.
- Saliu, Hasan, and Gazmend Abrashi. "The Return of Media Diplomacy: Examples from Kosovo". *Jurnal Ilmu Sosial dan Ilmu Politik* 27, no. 1 (2023): 74-89. <https://doi.org/10.22146/jsp.73710>
- Saliu, Hasan, Ramadan Çipuri, and Xhevahire Izmaku. "Gutenberg's Death in the Balkans: News Values in Kosovo and Albania." *Cogent Arts & Humanities* 11, no. 1 (2024): article 2303197. <https://doi.org/10.1080/23311983.2024.2303197>.
- Saliu, Hasan. "Multiple Target Audiences, Critical Analysis of Pristina-Belgrade Dialogue." *Modelling the New Europe*, no. 26/2018 (108-123). DOI:[10.24193/ojmne.2018.26.08](https://doi.org/10.24193/ojmne.2018.26.08)
- Saliu, Hasan. "Public diplomacy or public glocalization? Rethinking public diplomacy in the post-truth era". *Vestnik Moskovskogo universiteta. Seriya 10. Zhurnalistika*, 1, 157-175. 2022. DOI: [10.30547/vestnik.journ.1.2022.157175](https://doi.org/10.30547/vestnik.journ.1.2022.157175)
- Saliu, Hasan. "Rethinking Media Diplomacy And Public Diplomacy Towards A New Concept: Digital Media Diplomacy". *Modelling the New Europe*, 2022. <https://neweurope.centre.ubbcluj.ro/wp-content/uploads/2022/09/1.pdf>

- Saliu, Hasan. "Narratives of Public Diplomacy in the Post-Truth Era: The Decline of Soft Power". *Communication & Society* 36, no. 2 (2023): 209-224.
<https://doi.org/10.15581/003.36.2.209-224>.
- Saliu, Hasan. "Navigating Media Literacy in the AI Era: Analyzing Gaps in Two Classic Media Literacy Books". *Journal of Applied Learning & Teaching* 7, no. 2 (2024): 1-12. <https://doi.org/10.37074/jalt.2024.7.2.25>.
- Saliu, Hasan. *Komunikimi në diplomacinë publike: Soft power-i dhe imazhi ndërkombëtar i Kosovës*. Kolegji AAB: 2015.
- Scheufele, Dietram A. "Framing as a Theory of Media Effects." *Journal of Communication* 49, no. 1 (1999): 103–122,
- Seib, Philip. *Real-Time Diplomacy: Politics and Power in the Social Media Era*. Palgrave Macmillan, 2012.
- Smith, Steve, et al. *Politika e jashtme – teori, aktorë, raste*. UET Press, 2012.
- Spry, Damien. "Facebook diplomacy: a data-driven, user-focused approach to Facebook use by diplomatic missions." *Media International Australia* 168 (2018): 1329878X1878302. DOI:[10.1177/1329878X18783029](https://doi.org/10.1177/1329878X18783029)
- Statista. "Number of internet and social media users worldwide as of January 2024" Qasur më 1 mars, 2024. <https://www.statista.com/statistics/617136/digital-population-worldwide/#:~:text=Worldwide%20digital%20population%202023&text=As%20of%20October%202023%2C%20there,population%2C%20were%20social%20media%20users>.
- Surowiec, P., & Miles, Ch. "The Populist Style and Public Diplomacy: Kayfabe as Performative Agonism in Trump's Twitter Posts." *Public Relations Inquiry* 10, no. 1 (2021): 5–30. <https://doi.org/10.1177/2046147X20979294>
- Shahin, Saif, and Huang, Elyse. "Friend, Ally, or Rival? Twitter Diplomacy as 'Technosocial' Performance of National Identity." *International Journal of Communication* 13 (2019): 5100-5118.
- Sharma, Ashish, and Varsha Sisodia. "Digital diplomacy and the global pandemic." *Media Asia*, 2021. <https://doi.org/10.1080/01296612.2021.1973324>

- Shea, Cheryl S. Y., and Francis L. F. Lee. "Public Diplomacy via Twitter: Opportunities and Tensions." *Chinese Journal of Communication* 15, no. 3 (2022): 449-462.
<https://doi.org/10.1080/17544750.2022.2081988>.
- Tseng, Yu-Chin. "China's Twitter Diplomacy in Germany: Practices, Reactions, and Discrepancies." *Journal of Contemporary China* 33, no. 146 (2024): 295-313.
<https://doi.org/10.1080/10670564.2023.2193148>.
- Thunø, Mette, and Kristoffer Laigaard Nielbo. "The Initial Digitalization of Chinese Diplomacy (2019–2021): Establishing Global Communication Networks on Twitter." *Journal of Contemporary China* 33, no. 146 (2024): 244-266,
<https://doi.org/10.1080/10670564.2023.2195811>.
- Wu, Di, and Sevin, Efe. "Neither External nor Multilateral: States' Digital Diplomacy During Covid-19." *Journal of Public Diplomacy*, 2 (2022): 69-96.
DOI:[10.23045/jpd.2022.2.1.1](https://doi.org/10.23045/jpd.2022.2.1.1)
- Wu, H. Denis. "Post-Truth Public Diplomacy: A Detrimental Trend of Cross-National Communication and How Open Societies Address It." *The Journal of International Communication* 29, no. 1 (2023): 20-38.
<https://doi.org/10.1080/13216597.2022.2162099>.
- Xu, Cheng. "Diplomacy in a Social Media Environment: The Bargaining Model Revisited." *Canadian Foreign Policy Journal* (2023).
<https://doi.org/10.1080/11926422.2023.2218500>.
- Zaharna, R. S., & Huang, Z. A. "Revisiting public diplomacy in a postpandemic world: The need for a humanity-centered communication logic." *Communication and the Public*, 7(1), 7-14, 2022. <https://doi.org/10.1177/20570473221078619>